



Prishtinë: 02.09.2021

Kodi i ZRRE-së: V\_1378\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2165\_04\_21** i dt.23.04.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **21.05.2021**;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin M.XH nga Komuna e Mitrovicës, me shifër të konsumatorit DMI - 67787, si i pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2165\_04\_21, i datës 21.05.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 23.04.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2165\_04\_21 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit M.XH dhe e ka obliguar të Licencuarin KESCO që konsumatorit t'i korrigjoj të gjitha faturat nga periudha e vendosjes së njehsorit elektrik nr. 35032089 deri në periudhën 10/2016 për -50% të vlerës së faturuar të kilovatëve (kWh), kurse faturat e periudhës 11/2016 deri në periudhën 02/2017 kur edhe është përpiluar procesverbali nr.2468086 duhet të anulohen në tërësi, por të faturohen vetëm me tarifën fikse.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi për periudhën nga vendosja e njehsorit nr. 35032089 e deri në periudhën 10/2016 dhe pastaj nga periudha 11/2016 e deri me 02/2017 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor dhe sipas shpenzimit të krijuar nga konsumatori.
- KESCO thekson dhe mbron qëndrimin se faturimi ka qenë në rregull dhe kyçja e njehsorit nr.08194061 me shifër DMI 67786 në dalje të siguresave të konsumatori me shifër DMI 67787 nuk ka qenë për periudhë të gjatë dhe se kjo kyçje ka qenë momentale;
- Se konsumatori me shifër DMI 67787 ka mund të përdorë si alibi kyçjen e njehsorit nr.08194061 të shifrës DMI 67786, dëshmojnë rastet e shumëfishta të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2165\_04\_21 i datës 23.04.2021 për konsumatorin M.XH.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet që faturimi është i saktë, Bordi si të tillë e vlerëson të paqëndrueshëm dhe thekson se konsumatori me shifër DMI – 67787 është faturuar në kundërshtim me rregullat dhe procedurat në fuqi, sepse sipas Procesverbalit të Inspektimit nr. 2468086 i datës 10.02.2017, punëtorët e autorizuar të KEDS-it, pas inspektimit të pikës matëse të konsumatorit kanë evidentuar se konsumatori me shifër DMI – 67786 (Bajram Islami) ka qenë i lidhur në daljen e siguresave të konsumatorit M.XH dhe si rrjedhojë i ka shkaktuar shpenzim të energjisë elektrike. Po ashtu, ekipi i KEDS ka evidentuar se eliminohet kyçja dhe që konsumatori kërkon që t'i bëhet shkyçja e energjisë elektrike, si dhe që njehsori blombohet dhe mbetet i shkyçur.

Duke iu referuar Procesverbalit të Inspektimit nr.0869392 të datës 18.10.2017, me të cilin punëtorët e autorizuar të KEDS-it, pas inspektimit të pikës matëse të konsumatorit Bajram Islami me shifër DMI – 67786, është evidentuar se njehsori elektrik është i pa blombuar, si dhe me kapak të thyer dhe duket se nuk ka shpenzim.

Nuk mund të flitet për saktësi të faturimit, nëse në një situatë konkrete, si tek rasti i konsumatorit M.XH, ka qenë i kyçur një konsumator tjetër, në mënyrë ilegale, ashtu siç edhe është evidentuar nga vet punëtorët e KEDS-it. Është absolutisht jo relevante sa ka zgjatur kyçja, me vet faktin që në njehsor ka pasur ndërhyrje dhe parregullsi, në asnjë formë nuk mund të pretendohet për saktësi të faturimit. Andaj, Bordi thekson se vendimi i DMK-së është plotësisht në harmoni me gjendjen faktike të vërtetuar nga provat materiale si në shkresat e lëndës.

Duke u bazuar në të cekurat si më lartë, Bordi thekson se konsumatori me shifër DMI – 67787 (M.XH) është faturuar në kundërshtim me nenin nenin 28 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, e ku theksohet se: *“1 Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme); 2 Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit; 3 Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*. Bordi sqaron se argumenti i KESCO se korrigjimi financiar i konsumatorit nuk mund të bëhet për faktin se nuk dihet koha e saktë e kyçjes ilegale nuk qëndron pasi që për arsye se nuk mund të përcaktohet saktë periudha kohore atëherë nuk mund të ngarkohet konsumatori M.XH me shpenzime të cilat nuk i ka krijuar, pasi që vet KEDS ka konstatuar se *“konsumatori me shifër DMI 67786 dhe numër të njehsorit 08194061 ka qenë i lidhur në daljen e siguresave të konsumatorit të lartshënuar, si dhe i ka krijuar shpenzim” në procesverbalin nr.2468086 të datës 10.02.2017. Bazuar në të gjitha shkresat e lëndës DMK me të drejtë ka konstatuar se të gjitha faturat e konsumatorit nga periudha e*



vendosjes së njehsorit elektrik nr.35032089 deri në periudhën 10/2016 duhet të korrigojen për -50% të vlerës së faturuar të kilovatorëve (kWh), kurse faturat e periudhës 11/2016 deri në periudhën 02/2017 kur edhe është përpiluar procesverbali nr. 2468086 duhet të anulohen në tërësi, por të faturohet vetëm me tarifën fikse.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit M.XH. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar